



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1448/4 prot

Datë 08/08/2022

V E N D I M
Nr. 762/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08/08/2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “START CO” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-34467-06-27-2022, me objekt “Blerje material elektrike, viti 2022” me fond limit 9.943.574 (nëntë milion e nëntëqind e dyzetë e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Rruga Durrës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-34467-06-27-2022, me objekt “Blerje material elektrike, viti 2022” me fond limit 9.943.574 (nëntë milion e nëntëqind e dyzetë e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Rruga Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “START CO” SHPK
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla, G&P, Kati. 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja Rruga Durrës

Adresa: Lagja 14, Rruga "Haziz Shkupi" Shkozet-Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.06.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar" me Nr. REF-34467-06-27-2022, me objekt "Blerje material elektrike, viti 2022" me fond limit 9.943.574 (nëntë million e nëntëqind e dyzetë

e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Rruga Durrës..

II.2. Në datën 06.07.2022, operatori ekonomik ankimues “*START CO*” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe po më datë 06.07.2022 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 23.05.2022, është depozituar shkresa me objekt “*Informacion*”, protokolluar me tonën me nr. 1448/3 prot, datë 19.07.2022, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

“

1. Per piken 2 te ankeses, kjo ankese qendron.

Llampa Nave 250W, E40-Lm=25000(NAV-T)

-Shpjegimi do te jete ne SHTOJCEN bashkangjitur

2. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa Nave 250W, E40-Lm=25000

2. Per piken 3 te ankeses per llojet e llampave, kjo ankese qendron

a) Llampa Nave 100W, E40-Lm=7200

b) Llampa Nave 110W, E27-Lm=6500

c) Llampa Nave 150W, E40-Lm=15 165këh/1000H

-Shpjegimi do te jete ne SHTOJCEN bashkangjitur

3. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

a) Llampa Nave 100W, E40-Lm=7200, me presion te larte Sodiumi

b) Llampa Nave 110W, E27-Lm=6500, me presion te larte Sodiumi

c) Llampa Nave 150W, E40-Lm=15 165këh/1000H, me presion te larte Sodiumi

3. **Per piken 4 te ankeses per llojet e llampave, kjo ankese qendron**
Llampa ekonomike 75W, E27-5200 lumen, 6000-8000 h

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur

4.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa ekonomike fluoreshente 75W, E27-5200 lumen, 6000-8000 h

4. **Per piken 5 te ankeses per llojet e llampave, kjo ankese qendron**

Llampa NAV-TS 150super, 4Y, 150W, Lm=15000, Portollampe RX7/5-24

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.

5.Sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa NAVE 150W, Lm=15000, Portollampe RX7/5-24



Foto ilustruese

5. **Per piken 6 te ankeses, kjo ankese qendron.**

Llampsemaforike me percaktim etj....

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.

6.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa led 10 W, E 27, 15000 h, numri takim-stakim 25000-40000

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.

6. **Për pikën 7 të ankesës sipas specifikimeve fillestare, kjo ankese qendron**

a) Drozel 125W.....

b) Drozel 250W.....

c) Drozel 100W.....

-Shpjegimi do te jetë në **SHTOJCEN** bashkangjitur

7. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

a) Drozel 125W , reaktor 1.15A

b) Drozel 250W, reaktor 2.15A

c) Drozel 100 W, reaktor 1.2A”

7. **Per piken 8 te ankeses per kabujt elektrike, kjo ankese qendron pjeserisht.**

Kabuj sipas tabelës së Specifikimeve me numer rendor 18-23 dhe me numer rendro 48;49;50

*-Shpjegimi do të jetë në **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

8. sipas përgjigje ankese, Artikulli i kerkuar është

*-Kabuj elektrike me numer rendor 18-23 hiqet kërkesa **ME DY VESHJE**, pjesa tjetër e specifikimeve mbetet e pandyshuar*

8. Per piken 9 te ankeses, kjo ankese qendron.

Sipas tabelës së Specifikimeve me numer rendor 42; 43; 44 për artikullin Automate IP ...diferencial-magnto termik ON/OFF 1000

*-Shpjegimi do të jetë në **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

9.sipas përgjigje ankese, Artikulli i kerkuar është

-Automat 2P 16A diferencial ~ magneto termik

-Automat 2P 40A diferencial ~ magneto termik

-Automat 2P 25A diferencial ~ magneto termik

9. Per piken 10 te ankeses, kjo ankese qendron.

Sipas tabelës së specifikimeve teknike me numer rendor 51-55

*-Shpjegimi do të jetë në **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

10.sipas përgjigje ankese, Artikujt e kerkuar janë

a) Kokandricimi LED 100W, 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, jo me e vogël se 10500 Lumens, 50.000 Hours, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)

b) Prozhektor Led 100W, 220-240V, 25000 Hours, jo me të vogël se 10000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)

c)Prozhektor Led 150W. 220-240V, 50-60 Hz, jo me të vogël se 15000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)

d) Kokendricimi LED 50W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, jo me të vogël se 4953 Lumens, 50.000 Hours, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)

e) Kokendricimi LED 150W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, jo me të vogël se 15061 Lumens, 50.000 Hours, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)

10. Per piken 11 te ankeses, kjo ankese qendron pjeserisht.

Boksekomandimi 50x70cm

*-Shpjegimi do të jetë në **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

11.sipas përgjigje ankese, Artikulli i kerkuar është

Boksekomandimi nuk kërkohej të paraqitet si mostër në ditën e hapjes së ofertave.

Ndërsa në lidhje me gjendjen fizike të boksekomandimit ai duhet të jetë i kompletuar me të gjithë elementet përberes të boksit. I përberë nga:

a) Automat 4P-63A---cope 1

b) Automat 1P-25A----cope 4

c) Automat 1P-16A----cope 1

d) Leshues 63A-3 fazor----cope 1

e) Rrele muzgu 18A----cope 1

f) Salvavite 32A

g) Te shoqeruar boksi me shinat dhe elementet e tjere plotesues.

11. Per piken 12 te ankeses, kjo ankese qendron.

*Prozhektor special Maxi Woody me numer rendor ne tabelen e Specifikimeve 69
-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

12.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Prozhektor special compact Ø260mm, 24W, 3800lm, 4000K-5000K.

Sqarim i rendesishem, ky prozhektor kerkohet per Veprat e Artit te vendosura ne sheshet dhe rretrrotullimet e qytetit si Monumenti RODONI, Muri i Kalase dhe etj.....

Rendesia eshte tejet specifike.

12. Per piken 13 te ankeses, kjo ankese qendron.

Ndriculesi me emertimin Karin 2400 LED

*-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

13.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

NDRICUES Led, se bashku me shtylle alumini të ekstruduar me rezistence te larte ndaj korrodimit, H= 240cm me te gjithë aksesoret, Ngjyra e drites 3000-4500K.

Shkalla e mbrojtjes : IP65 ,Tensioni: 220V-240V Frekuenca: 50/60Hz

Ky lloj ndricuesi është një ndriçues me shtyllë veçanërisht për aplikime urbane, dizajn jashtëzakonisht i pastër dhe thelbësor për të këtë ndricues. Me shpërndarje vertikale të ndricuesit është e përshtatshme për të krijuar ambient efektet e ndriçimit veçanërisht të përshtatshme në aplikimet urbane dhe peizazhore. Difuzori polikarbonat është UV dhe rezistente ndaj goditjeve dhe garanton një dritë uniforme.

Ishte: Afati per hapje dhe pranim ofertash 12.07.2022 Ora: 10.00

BEHET: Afati per pranim dhe hapje ofertash behet data 3.08.2022 ora 10.00

Per sa me siper ashtu si kemi vendosur do te keni edhe SHTOJCEN me Specifikime te ndryshuara.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së datës 19.07.2022, me objekt “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1448/3 prot, datë 19.07.2022, rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke cituar se: “[...]”

1. Per piken 2 te ankeses, kjo ankese qendron.

Llampa Nave 250W, E40-Lm=25000(NAV-T)

-Shpjegimi do te jete ne SHTOJCEN bashkangjitur

2. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa Nave 250W, E40-Lm=25000

2. Per piken 3 te ankeses per llojet e llampave, kjo ankese qendron

a) Llampa Nave 100W, E40-Lm=7200

b) Llampa Nave 110W, E27-Lm=6500

c) Llampa Nave 150W, E40-Lm=15 165këh/1000H

-Shpjegimi do te jete ne SHTOJCEN bashkangjitur

3. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

a) Llampa Nave 100W, E40-Lm=7200, me presion te larte Sodiumi

b) Llampa Nave 110W, E27-Lm=6500, me presion te larte Sodiumi

c) Llampa Nave 150W, E40-Lm=15 165këh/1000H, me presion te larte Sodiumi

3. Per piken 4 te ankeses per llojet e llampave, kjo ankese qendron

Llampa ekonomike 75W, E27-5200 lumen, 6000-8000 h

-Shpjegimi do te jete ne SHTOJCEN bashkangjitur

4.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa ekonomike fluoreshente 75Ë, E27-5200 lumen, 6000-8000 h

4. Per piken 5 te ankeses per llojet e llampave, kjo ankese qendron

Llampa NAV-TS 150super, 4Y, 150W, Lm=15000, Portollampe RX7/5-24

-Shpjegimi do te jete ne SHTOJCEN bashkangjitur.

5.Sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa NAVE 150W, Lm=15000, Portollampe RX7/5-24




Foto ilustruese

5. **Per piken 6 te ankeses, kjo ankese qendron.**

Llampasemaforike me percaktim etj....

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.

6.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Llampa led 10 W, E 27, 15000 h, numri takim-stakim 25000-40000

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.

6. **Për pikën 7 të ankesës sipas specifikimeve fillestare, kjo ankese qendron**

d) Drozel 125W.....

e) Drozel 250W.....

f) Drozel 100W.....

-Shpjegimi do te jetë në **SHTOJCEN** bashkangjitur

8. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

a) Drozel 125W , reaktor 1.15A

b) Drozel 250W, reaktor 2.15A

c) Drozel 100 W, reaktor 1.2A”

7. **Per piken 8 te ankeses per kabujt elektrike, kjo ankese qendron pjeserisht.**

Kabuj sipas tabelës së Specifikimeve me numer rendor 18-23 dhe me numer rendro 48;49;50

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.

8. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

-Kabuj elektrike me numer rendor 18-23 hiqet kerkesa ME DY VESHJE, pjesa tjeter e specifikimeve mbetet e pandyshuar

8. **Per piken 9 te ankeses, kjo ankese qendron.**

Sipas tabelës së Specifikimeve me numer rendor 42; 43; 44 per artikut Automate 1P ...diferencial-magnto termik ON/OFF 1000

-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.

9.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

-Automat 2P 16A diferencial ~ magneto termik

-Automat 2P 40A diferencial ~ magneto termik

-Automat 2P 25A diferencial ~ magneto termik

9. Per piken 10 te ankeses, kjo ankese qendron.

Sipas tabelës se specifikimeve teknike me numer rendor 51-55

*-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

10.sipas pergjigje ankese, Artikujt e kerkuar jane

a) Kokandricimi LED 100W, 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, jo me e vogel se 10500 Lumens, 50.000 Hours, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)

b) Prozhektor Led 100W, 220-240V, 25000 Hours, jo me te vogel se 10000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)

c) Prozhektor Led 150W. 220-240V, 50-60 Hz, jo me te vogel se 15000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)

d) Kokendricimi LED 50W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, jo me te vogel se 4953 Lumens, 50.000 Hours, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)

e) Kokendricimi LED 150W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, jo me te vogel se 15061 Lumens, 50.000 Hours, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)

10. Per piken 11 te ankeses, kjo ankese qendron pjeserisht.

Boksekomandimi 50x70cm

*-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

11.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Boksekomandimi nuk kerkohet te paraqitet si moster ne ditën e hapjes se ofertave.

Ndersa ne lidhje me gjendjen fizike te bokskomandimit ai duhet te jete i kompletuar me te gjithë elementet perberes te boksit. I perbere nga:

h) Automat 4P-63A---cope 1

i) Automat 1P-25A----cope 4

j) Automat 1P-16A----cope 1

k) Leshues 63A-3 fazor----cope 1

l) Rrele muzgu 18A----cope 1

m) Salvavite 32A

n) Te shoqeruar boksi me shinat dhe elementet e tjere plotesues.

11. Per piken 12 te ankeses, kjo ankese qendron.

Prozhektor special Maxi Woody me numer rendor ne tabelen e Specifikimeve 69

*-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

12.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Prozhektor special compact Ø260mm, 24Ë, 3800lm, 4000K-5000K.

Sqarim i rendesishem, ky prozhektor kerkohet per Veprat e Artit te vendosura ne sheshet dhe rretrrotullimet e qytetit si Monumenti RODONI, Muri i Kalase dhe etj.....

Rendesia eshte tejet specifike.

12. Per piken 13 te ankeses, kjo ankese qendron.

Ndricuesi me emertimin Karin 2400 LED

*-Shpjegimi do te jete ne **SHTOJCEN** bashkangjitur.*

13.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

NDRICUES Led, se bashku me shtyllë alumini të ekstruduar me rezistence të lartë ndaj korrodimit, H= 240cm me të gjithë aksesoret, Ngjyra e dritës 3000-4500K. Shkalla e mbrojtjes : IP65 ,Tensioni: 220V-240V Frekuenca: 50/60Hz Ky lloj ndricuesi është një ndriçues me shtyllë veçanërisht për aplikime urbane, dizajn jashtëzakonisht i pastër dhe thelbësor për të këtë ndricues. Me shpërndarje vertikale të ndricuesit është e përshtatshme për të krijuar ambient efektet e ndriçimit veçanërisht të përshtatshme në aplikimet urbane dhe peizazhore. Difuzori polikarbonat është UV dhe rezistente ndaj goditjeve dhe garanton një dritë uniforme.

Ishte: Afati për hapje dhe pranimit ofertash 12.07.2022 Ora: 10.00

BEHET: Afati për pranimit dhe hapje ofertash behet data 3.08.2022 ora 10.00

Per sa me sipër ashtu si kemi vendosur do të keni edhe SHTOJCEN me Specifikime të ndryshuara. [...]"

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimit pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimit e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimit e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit

kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 1448 prot, datë 06.07.2022 e operatorit ekonomik “START CO” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “STAR CO” ShPK ku kërkon: **“I. Shtojca 7, seksioni 2.3- Kapaciteti Teknik Autoriteti juaj ka specifikuar ne kete shtojce se OE ofertues duhet te parashikojne ne oferten e tyre riparimin e ndricuesve te zerit 68 te shtojces 6- Formulari i sasise dhe grafikut te levrimit.**

Se pari gjykojme se pershkrimi teknik i ndricuesve ne seksionin 2.3-Kapaciteti teknik nuk percakton ne asnje pjese te tij se cfare difektesh kane keta ndricuesa dhe cila pjese e tyre duhet riparuar. Komponentet perberes te ketyre ndricueseve jane te shumte dhe kostot e tyre jane te ndryshme. Eshte e padrejte qe kjo pike te lihet e papercaktuar pasi ndikon ne menyre direkte ne cmimin e ofertuar dhe oferten totale te OE pjesmarres. Nisur nga sasia e parashikuar e riparimit te ketyre ndricueseve = 100 (njqind) jemi te bindur se vendosja e ketij zeri ne procedure vetem sa rendon me tej OE ofertues te percaktoje nje kosto te sakte dhe te parashikueshme pasni numri i ndricueseve eshte i madh dhe difektet e tyre mund te jene nga me te ndryshmet por AK i ka lene teresisht te papercaktuara.

Gjithashtu ne si OE me eksperience te gjate ne kete treg ku nder vite jemi njohur me te gjitha llojet e procedurave te prokurimit nga Autoritete Kontraktore te shumte, gjykojme se ky ze eshte vendosur ne menyre jo te rregullt ne kete procedure pasi lloji i procedures eshte “Mallra” dhe jo “Sherbime/Riparime”. Do te ishte me e drejte nga ana e AK te prokuronte nje procedure te vecante vetem per riparimin e ketyre ndricueseve, ku te percaktohej dhe nje raport i detajuar i difekteve per secilin prej tyre nga i cili do te hartohej nje preventiv me pjeset e cila jane jo funksionale dhe duhen zevendesuar. Ne kete menyre OE ofertues do te mund te ofertonin ne menyre te sakte cmimet e tyre per secilin komponent jo-funksional si dhe cmimet per riparimin e ketyre ndricueseve dhe rrjedhimisht gara do te ishte me e drejte dhe e hapur.

Ne keto kushte kerkojme nga AK te heqe kete ze nga preventivi i kesaj procedure pasi krijon konfuzion, eshte konfliktual me formatin “Procedure e Thjeshtuar – Mallra” si dhe detyron ofertuesit te paraqesin oferta ne “tym” te pasigurta dhe te paparashikueshme per ta. Gjithashtu menyra e vendosjes se ketij zeri ne kete procedure ndikon direkt ne pjemarrjen e OE-ve pasi jemi te bindur se sa me e paqarte te jete nje procedure aq me pak pjesmarrjes do te kete dhe ne kete menyre AK ngushton konkurrencen e lire dhe te drejte nga e cila ne fund te fundit eshte vet AK qe perfiton me shume.

II. Përsëri në shtojcën 7, pika 2.3- Kapaciteti Teknik, AK ka kërkuar nga OE ofertues të vërtetojnë se kanë të punësuar 1(një) punonjës elektrik të pajisur me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik S SH EN ISO/IEC 17024:2012 të kategorisë IV. Ak ka argumentuar: “Ju bashkangjisim këtë relacion teknik për të shpjeguar detyrën që do të kryejnë punonjësit elektrik të kërkuar me dëshmi Sigurimit Teknik S SH EN ISO/IEC 17024:2012 të Kategorisë IV. Do të

kryhet riparimi i 100 copë ndriçuesve LED 100Ë dhe LED 50Ë (në muajin qershor në prag të sezonit turistik). Fillimisht AK është jashtë afatit të realizimit të kryerjes së këtij shërbimi sepse procedura është publikuar në 30 Qershor 2022 dhe jemi tashmë brënda sezonit turistik...

Gjithashtu ky kriter është tërësisht jashtë kuadrit ligjor të kësaj procedure pasi është shprehur qartë se formati i saj është “Procedurë e Thjështuar-Mallra” dhe AK nuk ka asnjë të drejtë të kërkojë punonjës të kualifikuar teknikisht për të kryer riparime. Procedura e prokurimit është blerje mallrash dhe jo riparime pajisjesh.

Kërkojme nga ana e AK heqjen e këtij kriteri dhe heqjen e zërit Nr. 68 – Riparime ndricuesesh 100 copë nga kjo procedurë pasi është në kundërshtim me formatin ligjor të procedurës.”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në Seksioni 2: Objekti i Kontratës: BLERJE MATERIALE ELEKTRIKE, viti 2022, të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE është përcaktuar lloji i procedurës së prokurimit furnizim mallra, si më poshtë:

“2.3Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

Blerje Marrje me qira

×

Blerje me këste

Një kombinim i këtyre

III.2.2. Në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“4.OE duhet te kete te punesuar jo me pak se 1 punonjes elektrike te pajisur me Dëshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik S SH EN ISO/IEC 17024:2012 te disponojne Kategorine IV.

1• Ju bashkangjisim këtë relacion teknik për të shpjeguar detyrën që do të kryejnë punonjësit elektrik të kërkuar me dëshmi Sigurimit Teknik S SH EN ISO/IEC 17024:2012 të Kategorisë IV.

Do të kryhet riparimi i 100 copë ndriçuesve LED 100Ë dhe LED 50W (në muajin qershor në prag të sezonit turistik).

Të dhënat e ndriçuesve:

1.Ndriçues LED 100wIP65

SMD STREET LIGHT

OPERATION VOLTAGE

85-265V/50-60Hz

100Ë/6400K

8923Im

Average Life :30.000 Hrs

Instant Full Light

Beam Angle :120 °

On-Off : 25.000 x

2.Ndriçues LED 50W IP65

MODEL NO: VT-54ST
SKU: 958/4000 k[
Input voltage :AC 120-240V 50Hz
On/off time > 15,000
LUMINOUS: 6000LM
Beam Angle 110°
CRI : > 70

- Keto jane ndricuesit e kerkuar sipas numrit 68 tek Tabela e Specifikimeve:”.

III.2.3. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

“3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

3.OE duhet te kete te punesuar jo me pak se 1 punonjes te pajisur me Dëshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik S SH EN ISO/IEC 17024:2012 te Kategorise IV

4.Punonjesi elektrik kerkohet te jete ne listepagesen e Sigurimeve Shoqerore per muajin maj 2022

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht: Vendim KM nr.538, datë 26.5.2009 “për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta edhe sipas Vendimit nr.107 date 10.02.2016 te KM „Per nje shtese ne vendimin numer 538 date 26.05.2009 te KM „per licensat dhe lejet qe trajtohen nga qendra kombetare e licensimit dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa“ i ndryshur

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë puntore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kontrates. Autoriteti kontraktor (njesia e prokurimit) ka kerkuar paraqitjen e listpageses se muajit per arsye se eshte muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, Bazuar ne ligjin nr.9136 date 11.09.2003“Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Republikene Shqiperise“ i ndryshuar (neni 11Afatet e deklarimit dhe te pageses), operatoret ekonomike kane afat shlyerje detyrimesh tek sigurimet shoqerore e shendetesore brenda dates 20te muajit pasardhes.

Pjese e specifikimeve teknike eshte edhe riparimi i ndicuesve te demtuar dhe per kete arsye kerkohet edhe ky staf i specializuar,

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.4. Në Shtojcën 6 “**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**”, të dokumenteve të tenderit është parashikuar si më poshtë vijon:

“Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

1	Llampa Nave 250W, E40, Lm=25000 (NAV-T)	350
2	Llampa Nave 100W, E40, Lm=7200	100
3	Llampa Nave 110W, E27, Lm=6500	10
4	Llampa Nave 150W, E40, Lm=1500 165 KWh/1000H	150
5	LlampaHql 125W, E27, Lm=6500	250
6	LlampaHql 250W, E40, Lm=13000	100
7	Llampaekonomike 75W, E27, 5200 Lumen, 6000-8000 Ore	100
8	Llampa NAV-TS 150 super 4Y, 150W, Lm=15000, Portollampe Rx 7/5-24	30
9	Llampasemaforike a: Krypton 60-75W, E27, Lm=340-480, ore punemesatare h=14000 b: LED 10W ekuivalente 80W, Lm=957, E27, ore pune h=15000, nr. takim-stakimeve 25000-40000	200
10	Portollampaporcelani E40 me dykrahefiksues	60
11	Portollampaporcelani E27 me dykrahefiksues	100

12	Pershtates E40, E27 230V	100
13	Izolant i zakoshem (0.15mm x 19mm x 25mm) Me veteshuarje	800
14	Izolantskotch 70390 (paragome) Max 600V,80°C	50
15	Drosel 125W (reaktor) 1.15A, Tw 130, Dt 70 230V/50Hz I0.56	50
16	Drosel 250W (reaktor) 2.15A, Tw 130, Dt 75 230V/50Hz I0.55	100
17	Drosel 100W (reaktor) 1.2A, Tw 130, Dt 75 230V/50Hz I0.43	30
18	Kabell 2x1.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
19	Kabell 3x1.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	4,000
20	Kabell 3x2.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,500
21	Kabell 4x2.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,500
22	Kabell 5x4mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
23	Kabell 4x4mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
24	Intek E 400 CHP5, 70ts-400W (ndezes)	100
25	Foto element 16A, 230V Max 2300W IP 54 Profesional	120
26	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12110 f 110mm gri	150
27	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12160 ff160mm I Kuq	100
28	Morsetaelektrike E-16 Mono Fazore	400
29	Konektor A.B.C.	72
30	Percjelles CU N07V-K 1x4mm ² Kundrazjarrit	1,000
31	Percjelles CU N07V-K 1x6mm ² Kundrazjarrit	1,000
32	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 25A 4Kw, 220V, 50/60Hz, D 09,12,18	50
33	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 40A 11Kw,220V, 50/60Hz, D 25,32	50
34	Paketeelektronike per ndricues LED driver Pn=80W, DC 20-40V, 27A, 320W	70
35	Percjelles CPR N07V-K 1x10mm ² Per Tokezim	

		300
36	Automat 4P, 40A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	50
37	Automat 4P, 63A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	40
38	Kapakshtyllash "ZIPO" fi 70-109, CE ART. 940 oseekuivalent	200
39	Kapakshtyllash "OEC" 115-180, ART. 66653 oseekuivalent	200
40	Upaplastike ø12, Vida metrike M12	400
41	Lidheseplastike L=170mm Æ3-50mm Max 180N PA 6.6	4,000
42	Automat 1P 40A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	60
43	Automat 1P 16A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	40
44	Automat 1P 25A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	60
45	Automat 1P/10A ~ magneto termik ON/OFF 6000	30
46	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12040 f 40mm gri	200
47	Drosel 150W (reaktor)	40
48	Kabell 5x6 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	1,000
49	Kabell 5x10 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	500
50	Kabell 4x16 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	200
51	Kokandricimi LED 100W, 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 10500 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	200
52	Prozhektor Led 100W smd LED Indus. 220-240V, 25000 Hours, 120° ta -20° +50°C, 10000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)	20
53	Prozhektor Led 150W smd Led Indus. 220-240V, 50-60 Hz, 25000 hours, 120° ta -20° +50°C, 15000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)	20
54	Kokendricimi LED 50W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 4953 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	200
55	Kokendricimi LED 150W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 15061 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	50

56	Llamba Bulb LED 40 W 3520LUMEN E27, 30000 Ore, 30000 ON/OFF, 270°, A+	150
57	Mufte TU Per KablloPlastik/PVC Pa armature 1KV:50-70mm2	8
58	Llampaekonomike 23-30W, Lm=1200, ore pune h=6000-800	300
59	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 63A 22Kw, 220V, 50/60Hz, D40,63	50
60	Automat 4P, 100A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	10
61	Pusetaplastikeelektrike (20cm x 20cm x 20cm)	30
62	Leshues 3 fazor, U(bob), 220V/100A	15
63	Boksekomandimi 50cmx70cm i kompletuar (garanci 2 vjet)	5
64	NdricuesRrugor I kompletuar me 2 koka LED(Sipasskemes)(Garanci 2 vjet)	19
65	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12090 f 90mm I zi	100
66	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12075 f 75mm I zi	100
67	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12063 f 63mm I zi	100
68*	Riparimndricuesash LED	100
69	Prozhektor special Maxi Woody compact fi 260mm 24W 3800lm s10? 4000K	4
70	Shtylla CILINDRIKE me lartesi 240cm , me strukturalumini	6
71	Ndricues LED Dekorativ, fuqia 60w	4
72	Paketaelektronike (Driver 1400 mA)	38
73	Ndricues LED Dekorativ ne formehinke	3

III.2.5. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën e datës 19.75.2022 është shprehur se: “1. Pika e parë e ankesës, sipas Shtojcës 7 seksioni 2.4 Kapaciteti Teknik, qendron pjesërisht. a). Germa I ankesa është e drejtë në lidhje me shpjegimin për llojet e difekteve, do të jepet shpjegim teknik me **SHTOJCE**. 1. Per ndricuesit qe do te riparohen 100 COPE -50 cope kerkojne riparim te paketes elektronike -50 cope difekti i konstatuar nga ana jone eshte MASE ne TRUP

Sqarim rregullues: punonjesi elektrik duhet te kete kualifikim jo me pak se Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik S SH EN ISO/IEC 17024:2012 te Kategorise IV

B). Germa II ankesa nuk qendron, ne lidhje me punonjesin e kualifikuar pasi per rregullimin e difekteve duhet nje punonjes i kualifikuar.

Sqarim zeri i preventivit per riparimin e defekteve eshte minimalist, ne kuptimin e percaktimit te llojit te procedures. Pra duhet te jete Mallra apo Sherbime”, duke mos pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

III.2.6. Në nenit 77, pika 4 dhe pika 5 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve..”.

III.2.7. Në nenin 40, pika 1, pika 2 dhe pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.7.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit ku kërkon të hiqet ky kriter dhe zëri me nr. 68 nga preventivi i kësaj procedure prokurimi pasi është konfliktual me formatin “Procedurë e

Thjeshtuar – Mallra”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i vendosur si dhe zëri numër. 68 në Shtojcën. 6 “*Formulari i sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit*” nga ana e autoritetit kontraktor është konfuz dhe i paqartë dhe që sjell paqartësi tek operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe për më tepër kjo kërkesë nuk shpreh as qëllimin për të cilin është përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe nuk është argumentuar teknikisht dhe ligjërish. Në këtë kuadër Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të ndajë qartë nëse objekti i kësaj procedurë prokurimi është mallra apo shërbime/mirëmbajtje, prandaj me rishpalljen e procedurës së prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor ky specifikim dhe kriter duhet të hiqet, pasi sjellin paqartësi tek ofertuesit dhe nuk janë në përpjestim me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*START CO*” ShPK ku kërkon: “III. Ne shtojcën 5- Formulari i specifikimeve teknike, AK ka pasqyruar ne forme tabelare specifikimet teknike te mallrave objekt prokurimi ku verejme se mallrat jane specifikuar ne emertimin e tyr pa ndonje informacion shtese. Ne keto kushte kemi hasur shkeljet e meposhtme:

[...]

Zerat 18-23 Kabell FROR ... me dy veshje

Zerat 48, 49, 50. Kabeel ... kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V

Ne lidhje me specifikimet teknike te ketyre zerave gjykojme se AK ka vendosur specifikimet konfliktuale pasi sipas standarteve me koherente te kablllove CU te tensionit te ulet nuk ekziston nje tip kablli me kodin FROR dhe gjithashtu te kete dy veshje. Si me poshte po ju bashkengjisim foto nga katalogu i nje nga prodhueseve me te njohur ne treg ku percaktohen veshjet e kabllit FROR dhe kodin e kabllit me dy veshje ku qartesoher se kemi te bejme me dy produkte te ndryshme.... Gjithashtu referuar dhe argumentimit te mesiperem, ne lidhje me zerat 38,39,50 kemi te bejme me nje konflikt brenda specifikimeve teknike te kerkuara pasi me te njejtin kod FROR, AK ka kerkuar kabell te gomuar, PVC me dy shtresa dhe kundrazjarrit. Percaktime te cilat nuk kane lidhje me kod FROR apo FS180OR sipas standartit te ri. Kerkojme nga AK te beje ndryshimet e nevojshme per te percaktuar qarte kodin e kabllit qe kerkohet pasi kemi te bejme me specifikime konfliktuale qe rrjedhimisht e bejne cdo produkt te ofertuar te jete jo ne perputhje me specifikimet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Shtojcën 5 “*FORMULAR I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” dokumenteve të tenderit është parashikuar si më poshtë vijon:

“Shtojca 5.

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

1	Llampa Nave 250W, E40, Lm=25000 (NAV-T)	350
---	---	-----

2	Llampa Nave 100W, E40, Lm=7200	100
3	Llampa Nave 110W, E27, Lm=6500	10
4	Llampa Nave 150W, E40, Lm=1500 165 KWh/1000H	150
5	LlampaHql 125W, E27, Lm=6500	250
6	LlampaHql 250W, E40, Lm=13000	100
7	Llampaekonomike 75W, E27, 5200 Lumen, 6000-8000 Ore	100
8	Llampa NAV-TS 150 super 4Y, 150W, Lm=15000, Portollampe Rx 7/5-24	30
9	Llampasemaforike a: Krypton 60-75W, E27, Lm=340-480, ore punemesatare h=14000 b: LED 10W ekuivalente 80W, Lm=957, E27, ore pune h=15000, nr. takim-stakimeve 25000-40000	200
10	Portollampaporcelani E40 me dykrahefiksues	60
11	Portollampaporcelani E27 me dykrahefiksues	100
12	Pershtates E40, E27 230V	100
13	Izolant i zakoshem (0.15mm x 19mm x 25mm) Me veteshuarje	800
14	Izolantskotch 70390 (paragome) Max 600V,80°C	50
15	Drosel 125W (reaktor) 1.15A, Tw 130, Dt 70 230V/50Hz 10.56	50
16	Drosel 250W (reaktor) 2.15A, Tw 130, Dt 75 230V/50Hz 10.55	100
17	Drosel 100W (reaktor) 1.2A, Tw 130, Dt 75 230V/50Hz 10.43	30
18*	Kabell 2x1.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
19*	Kabell 3x1.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	4,000
20*	Kabell 3x2.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,500
21*	Kabell 4x2.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,500
22*	Kabell 5x4mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
23*	Kabell 4x4mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
24	Intek E 400 CHP5, 70ts-400W (ndezes)	100

25	Foto element 16A, 230V Max 2300W IP 54 Profesional	120
26	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12110 f 110mm gri	150
27	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12160 ff160mm I Kuq	100
28	Morsetaelektrike E-16 Mono Fazore	400
29	Konektor A.B.C.	72
30	Percjelles CU N07V-K 1x4mm2 Kundrazjarrit	1,000
31	Percjelles CU N07V-K 1x6mm2 Kundrazjarrit	1,000
32	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 25A 4Kw, 220V, 50/60Hz, D 09,12,18	50
33	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 40A 11Kw,220V, 50/60Hz, D 25,32	50
34	Paketeelektronike per ndricues LED driver Pn=80W, DC 20-40V, 27A, 320W	70
35	Percjelles CPR N07V-K 1x10mm2 Per Tokezim	300
36	Automat 4P, 40A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	50
37	Automat 4P, 63A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	40
38	Kapakshtyllash "ZIPO" fi 70-109, CE ART. 940 osekuivalent	200
39	Kapakshtyllash "OEC" 115-180, ART. 66653 osekuivalent	200
40	Upaplastike ø12, Vida metrike M12	400
41	Lidheseplastike L=170mm Æ3-50mm Max 180N PA 6.6	4,000
42	Automat 1P 40A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	60
43	Automat 1P 16A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	40
44	Automat 1P 25A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	60
45	Automat 1P/10A ~ magneto termik ON/OFF 6000	30
46	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12040 f 40mm gri	200
47	Drosel 150W (reaktor)	40
48*	Kabell 5x6 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	1,000
49*	Kabell 5x10 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	500

50*	Kabell 4x16 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	200
51	Kokandricimi LED 100W, 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 10500 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	200
52	Prozhektor Led 100W smd LED Indus. 220-240V, 25000 Hours, 120° ta -20° +50°C, 10000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)	20
53	Prozhektor Led 150W smd Led Indus. 220-240V, 50-60 Hz, 25000 hours, 120° ta -20° +50°C, 15000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)	20
54	Kokendricimi LED 50W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 4953 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	200
55	Kokendricimi LED 150W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 15061 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	50
56	Llamba Bulb LED 40 W 3520LUMEN E27, 30000 Ore, 30000 ON/OFF, 270°, A+	150
57	Mufte TU Per KablloPlastik/PVC Pa armature 1KV:50-70mm2	8
58	Llampaekonomike 23-30W, Lm=1200, ore pune h=6000-800	300
59	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 63A 22Kw, 220V, 50/60Hz, D40,63	50
60	Automat 4P, 100A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	10
61	Pusetaplastikeelektrike (20cm x 20cm x 20cm)	30
62	Leshues 3 fazor, U(bob), 220V/100A	15
63	Boksekomandimi 50cmx70cm i kompletuar (garanci 2 vjet)	5
64	NdricuesRrugor I kompletuar me 2 koka LED(Sipasskemes)(Garanci 2 vjet)	19
65	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12090 f 90mm I zi	100
66	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12075 f 75mm I zi	100
67	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12063 f 63mm I zi	100
68	Riparimndriqesash LED	100
69	Prozhektor special Maxi Woody compact fi 260mm 24W 3800lm s10? 4000K	4
70	Shtylla CILINDRIKE me lartesi 240cm , me strukturealumini	6

71	Ndricues LED Dekorativ, fuqia 60w	4
72	Paketaelektronike (Driver 1400 mA)	38
73	Ndricues LED Dekorativ ne formehinke	3

”.

III.3.2. Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën e datës 19.75.2022 është shprehur se: **“Për pikën 8 të ankesës për kabujt elektrikë, kjo ankese qendron pjesërisht.**

Kanuj sipas tabelës së Specifikimeve me numër rendor 18-23 dhe me numër rendor 48; 49; 50 -Shpjegimi do te jetë në SHTOJCEN bashkangjitur

8. sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

- **Kabuj elektrikë me numër rendor 18-23** hiqet kërkesa ME DY VESHJE, pjesa tjetër e specifikimeve mbetet e pandryshuar.
- dhe me numër rendor 48; 49; 50 të tabelës së specifikime kërkesa mbeten të pandryshuara”. duke pranuar pjesërisht këtë pretendim të ankimuesit.

III.3.3. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur

këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.3.3.1. Për sa i përket pretendimit të ankimesit lidhur me përcaktimin e qartë kodin e kabllit që kërkohet në zërat 48, 49, 50 të Shtojcës 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit si dhe ka detyrë të përcaktojë kriteret dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me shërbimin e kërkuar. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimesit lidhur me përcaktimin e qartë të kodit të kabllit, si dhe kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor, ky i fundit i ka lënë të pa ndryshuar zërat 48, 49, 50. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën, si dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues duhet të marrë masa për përcaktimin sa më të saktë të kodit të kabllit, që ka përcaktuar në specifikimet teknike, pasi sjell konfuzion tek operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin

pjesë në këtë procedurë prokurimi prandaj me rishpalljen e procedurës së prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor duhet të bëhen ndryshimet e këtij specifikimi, pasi sjell konfuzion tek ofertuesit.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “START CO” ShPK ku kërkon: “[...] III. Në shtojcën 5- Formulari i specifikimeve teknike, AK ka pasqyruar në formë tabelare specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi ku vërejmë se mallrat janë specifikuar në emërtimin e tyre pa ndonjë informacion shtesë. Në këto kushte kemi hasur shkeljet e mëposhtme: Zeri 69 Prozhektor special Maxi Woodt compact fi 360mm 24W 3600lm s10? 4000K Fillimisht AK ka përmendur emër tregtar të prodhuesit të këtyre ndricueseve. Maxi Woody është prodhues dhe emrat e vecante tregtar nuk lejohen të përdoren në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu në specifikimet teknike të këtij zeri vëmë re: s10?, kërkojmë të qartësohemi për këto parametra pasi nuk ben kuptim nga ana teknike. Me tej AK ka specifikuar perseri vlerem e Lument të këtij ndricuesi 3800Lm, kërkojmë të vendosen diapazonet perseri sepse jemi në ngushtim të plote të konkurrencës.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në Shtojcën 5 “FORMULAR I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” dokumenteve të tenderit është parashikuar si më poshtë vijon:

“Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]
FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

1	Llampa Nave 250W, E40, Lm=25000 (NAV-T)	350
2	Llampa Nave 100W, E40, Lm=7200	100
3	Llampa Nave 110W, E27, Lm=6500	10
4	Llampa Nave 150W, E40, Lm=1500 165 KWh/1000H	150
5	LlampaHql 125W, E27, Lm=6500	250
6	LlampaHql 250W, E40, Lm=13000	100
7	Llampaekonomike 75W, E27, 5200 Lumen, 6000-8000 Ore	100
8	Llampa NAV-TS 150 super 4Y, 150W, Lm=15000, Portollampe Rx 7/5-24	30
9	Llampasemaforike a: Krypton 60-75W, E27, Lm=340-480, ore punemesatare h=14000 b: LED 10W ekuivalente 80W, Lm=957, E27, ore pune h=15000, nr. takim-stakimeve 25000-40000	200

10	Portollampaporcelani E40 me dykrahefikses	60
11	Portollampaporcelani E27 me dykrahefikses	100
12	Pershtates E40, E27 230V	100
13	Izolant i zakoshem (0.15mm x 19mm x 25mm) Me veteshuarje	800
14	Izolantskotch 70390 (paragome) Max 600V,80°C	50
15	Drosel 125W (reaktor) 1.15A, Tw 130, Dt 70 230V/50Hz 10.56	50
16	Drosel 250W (reaktor) 2.15A, Tw 130, Dt 75 230V/50Hz 10.55	100
17	Drosel 100W (reaktor) 1.2A, Tw 130, Dt 75 230V/50Hz 10.43	30
18	Kabell 2x1.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
19	Kabell 3x1.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	4,000
20	Kabell 3x2.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,500
21	Kabell 4x2.5mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,500
22	Kabell 5x4mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
23	Kabell 4x4mm ² PVC kundrazjarrit CU FROR 450/750V me dyveshje	1,000
24	Intek E 400 CHP5, 70ts-400W (ndezes)	100
25	Foto element 16A, 230V Max 2300W IP 54 Profesional	120
26	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12110 f 110mm gri	150
27	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12160 ff160mm I Kuq	100
28	Morsetaelektrike E-16 Mono Fazore	400
29	Konektor A.B.C.	72
30	Percjelles CU N07V-K 1x4mm ² Kundrazjarrit	1,000
31	Percjelles CU N07V-K 1x6mm ² Kundrazjarrit	1,000
32	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 25A 4Kw, 220V, 50/60Hz, D 09,12,18	50
33	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 40A 11Kw,220V, 50/60Hz, D 25,32	50

34	Paketeelektronike per ndricues LED driver Pn=80W, DC 20-40V, 27A, 320W	70
35	Percjelles CPR N07V-K 1x10mm2 Per Tokezim	300
36	Automat 4P, 40A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	50
37	Automat 4P, 63A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	40
38	Kapakshtyllash "ZIPO" fi 70-109, CE ART. 940 osekuivalent	200
39	Kapakshtyllash "OEC" 115-180, ART. 66653 osekuivalent	200
40	Upaplastike ø12, Vida metrike M12	400
41	Lidheseplastike L=170mm Æ3-50mm Max 180N PA 6.6	4,000
42	Automat 1P 40A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	60
43	Automat 1P 16A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	40
44	Automat 1P 25A diferencial ~ magneto termik ON/OFF 1000	60
45	Automat 1P/10A ~ magneto termik ON/OFF 6000	30
46	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12040 f 40mm gri	200
47	Drosel 150W (reaktor)	40
48	Kabell 5x6 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	1,000
49	Kabell 5x10 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	500
50	Kabell 4x16 kundrazjarrit (PVC) I Gomuar FROR450/750V	200
51	Kokandricimi LED 100W, 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 10500 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	200
52	Prozhektor Led 100W smd LED Indus. 220-240V, 25000 Hours, 120° ta -20° +50°C, 10000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)	20
53	Prozhektor Led 150W smd Led Indus. 220-240V, 50-60 Hz, 25000 hours, 120° ta -20° +50°C, 15000 Lumens, 3000K/4000K/6000K, IP 65 (Garancia 2 vjet)	20
54	Kokendricimi LED 50W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 4953 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	200

55	Kokendricimi LED 150W 100/265V, 50/60Hz, 3000K/4200K/6500K, 15061 Lumens, 50.000 Hours, Rreze 135°, ON-OFF 25000x, IP 65 (Garancia 2 vjet)	50
56	Llamba Bulb LED 40 W 3520LUMEN E27, 30000 Ore, 30000 ON/OFF, 270°, A+	150
57	Mufte TU Per KablloPlastik/PVC Pa armature 1KV:50-70mm2	8
58	Llampaekonomike 23-30W, Lm=1200, ore pune h=6000-800	300
59	Leshues 3F, U/Bob, 220V, 63A 22Kw, 220V, 50/60Hz, D40,63	50
60	Automat 4P, 100A, 380V ~ magneto termik ON/OFF 1000	10
61	Pusetaplastikeelektrike (20cm x 20cm x 20cm)	30
62	Leshues 3 fazor, U(bob), 220V/100A	15
63	Boksekomandimi 50cmx70cm i kompletuar (garanci 2 vjet)	5
64	NdricuesRrugor I kompletuar me 2 koka LED(Sipasskemes)(Garanci 2 vjet)	19
65	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12090 f 90mm I zi	100
66	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12075 f 75mm I zi	100
67	Tub Freksibel PVC me dyshtresa RP 12063 f 63mm I zi	100
68	Riparimndriçuesash LED	100
69*	Prozhektor special Maxi Woody compact fi 260mm 24W 3800lm s10? 4000K	4
70	Shtylla CILINDRIKE me lartesi 240cm , me strukturealumini	6
71	Ndricues LED Dekorativ, fuqia 60w	4
72	Paketaelektronike (Driver 1400 mA)	38
73	Ndricues LED Dekorativ ne formehinke	3

”.

III.4.2. Lidhur me këtë pretendim të ankimesit autoriteti kontraktor me shkresën e datës 19.75.2022 është shprehur se: **“Për pikën 12 të ankesës, kjo ankese qendron.**

Prozhektor special Maxi Woody me numer rendor ne tabelen e Specifikimeve 69

*-Shpjegimi do te jetë në **SHTOJCEN** bashkangjitur*

12.sipas pergjigje ankese, Artikulli i kerkuar eshte

Prozhektor special compact Ø260mm, 24W, 3800lm, 4000K-5000K.

Sqarim i rendesishem, ky prozhektor kerkohet per Veprat e Artit te vendosura ne sheshet dhe rretrotullimet e qytetit si Monumenti RODONI, Muri i Kalase dhe etj..... Rendesia eshte tejet specifike.

III.4.3. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.4.3.1. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit si dhe ka detyrë të përcaktojë kriteret dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me shërbimin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret apo specifikime të cilat mund të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në cilësinë e shërbimit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimuesit lidhur me vendosjen e diapazonit e Lumens, si dhe kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor, ky i fundit në asnjë moment nuk ka argumentuar se si dhe çfarë pasojash sjell në ofrimin e shërbimit apo në sigurinë mjedisore modifikimi i këtij diapazoni, duke mos dhënë një shpjegim të natyrës teknike, por një shpjegim narrativ si “*Sqarim i rendesishëm, ky prozhektor kerkohet per Veprat e Artit te vendosura ne sheshet dhe rrethrotullimet e qytetit si Monumenti RODONI, Muri i Kalase dhe etj.... Rendesia eshte tejet specifike*”. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për zgjerimin e diapazonit të Lumens të zërit 69 egzakhtësisht “*Prozhektor special compact Ø260mm, 24W, 3800lm, 4000K-5000K*”, që ka përcaktuar në specifikimet teknike, në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën, si dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, prandaj me rishpalljen e procedurës së prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor duhet të bëhen ndryshimet përkatëse të këtij specifikimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i hartimit dhe përcaktimit të dokumenteve standarde të tenderit është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, për shkaqet e sipërcituara, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentet e tenderit janë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e tyre. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar, kriteret për kualifikim, specifikimet teknike dhe preventivin e kontratës të unifikuara, si dhe në përputhje me nevojat reale.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “START CO” SHPK për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-34467-06-27-2022, me objekt “Blerje material elektrike, viti 2022” me fond limit 9.943.574 (nëntë million e nëntëqind e dyzetë e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër)

Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Rruga Durrës.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “START CO” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor në rishpalljen e procedurës të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në përputhje me konstatimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “START CO” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
KreshnikTernova

Kryetar
Jonaid Myzyri